



Marrëveshje bashkëpunimi  
midis Ministris së Shëndetsis dhe Agenas

**Fushata informative  
“Përdorimi korrekt i shërbimeve të rasteve të  
jashtëzakonshme – urgjencave”**

**Përbajtja informative**



**Fushata informative**  
**“Përdorimi korrekt i shërbimeve të rasteve të jashtëzakonshme – urgjencave”**  
**Përmbajtjet informuese të përbashkëta në nivel kombëtar.**

Ministria e Shëndetësisë dhe Agenas - Agjencia kombëtare për shërbimet shëndetsore

Krahinore, në bashkëpunim me Krahinat dhe Provincat e Pavarura të Trentos dhe Bolzanos, kanë nisur zbatimin e një fushatë informative kombëtare mbi përdorimin e përshtatshëm të shërbimeve të gjendje së jashtëzakonshme – urgjencave dhe të shërbimit të asistencës së vazhdueshme.

Fushata ka qellim të informojë dhe të sensibilizojë të gjithë popullsinë, me kujdes të veçant drejtuar të rinjve dhe të huajve, mbi përdorimin e përshtatshëm të shërbimeve, mbi parimin që një qytetar i mirë informuar është një qytetar më i ndërgjegjshëm në njojen e nevojave të shendetit të tij dhe të individualizojë në bazë të tyre strukturën e duhur më të përshtatshme.

Fushata kombëtare parashikon një bazë informuese të përcaktuar në akord me literaturen dhe me eksperiencat ndërkombëtare dhe kombëtare të lidhura ngushtë me fushatat informative në shëndetsi - dhe në veçanti ndërhyrjet e drejtuara në përdorimin drejtë të shërbimeve të gjëndjes së jashtëzakonshme – e urgjencave.

Në faqet që vijojnë paraqiten përmbajtet specifike të bazes informative që është mbështetur në nivel kombëtar nga të gjithë Krahinat dhe Shoqëritë e Kolegjet, Shoqatat shkencore dhe Organizatat profesionale të sektorit.

## ÇFARE ESHTE NUMRI 1-1-8

- 1-1-8 është numri telefonik, i njëjtë në të gjithë territorin kombëtar, që i referohet të gjitha rasteve të kerkesës të ndihmës së shpejtë shëndetsore në një situatë të jashtezakonshme – urgjencia \*.
- Numri 1-1-8 vë në kontakt qytetarin me një Qendër Operative që merr telefonatat, vlerëson gravitetin e gjendjes dhe, se është e nevojshme, dërgon personelin dhe mjetet e nevojshme të ndihmes së shpejtë në bazë të gjendjeve specifike të duhur. Qendra koordinon ndihmën nga vendi i ngjarjes deri në spitalin më të përshtashëm.
- 1-1-8 është një numër gratis dhe është aktiv në të gjithë territorin kombëtar pa ndërprerje për 24 orë rrjesht.
- Numrit 1-1-8 mund t'i telefonohet nga çfarëdolloj telefoni, fiks o celular (mobil). Telefonat celulare përdoren për të bere telefonata përkundrejt numrave të ndihmës së shpejtë (118, 112, 113, 115) edhe në rast se skeda nuk ka kredit. Se telefonohet nga një kabinë telefonike nuk është e nevojshme as monedha dhe as skeda

\*

### Gjendje e jashtezakonshme

1. Në bazë të statistikës jo e shpeshtë
2. Përfshin një ose më shumë pacientë
3. Ekziston rreziku i vdekjes së menjëherëshme
4. Kërkon ndërhyrje terapeutike dhe shpëtim jete të menjëherëshme ose për një kohe sa më të shpejtë të mundur

### Urgjenza

1. Në bazë të statistikës më e shpeshtë
2. Përfshin një ose më shumë pacientë
3. Nuk ekziston rreziku i vdekjes së menjëherëshme
4. Kërkon ndërhyrje terapeutike brenda një kohe të shkurtër

## PER T'I TELEFONUAR NUMRIT 1-1-8

### Kur i telefonohet numrit 1 – 1 – 8

Në të gjitha rastet në të cilat mund të rrezikohet jeta ose siguria e një personi si në rast të :

- vështirësie ose mungese të fryshtëzimit
- dhimbje në gjoks
- humbje të zgjatur të ndenjave ( personi nuk flet e nuk përgjigjet)
- trauma dhe plagë me hemoragji të dukshme
- aksident (shtëpijak, rrugor, sportiv, bujqësor, industrial)
- vështirësi në të folur ose vështirësi/ paaftësi në përdorimin e një ose të gjymtyrëve të së njëjtës anë (krah).
- shenja të mbytjes(zënie fryme), helmimi, mbytje në uje ose djeg'jeje.

### Si i telefonohet numrit 1 – 1 – 8

- Bëhet numri telefonik 1 - 1 - 8
- Përgjigjuni me qetësi pyetjeve të bëra nga operatori dhe prisni në telefon për të gjithëkohën që duhet
- Të lesh (japësh) numrin e telefonit
- Të tregohet vendi i ngjarjes (komuna, rruga, numri )
- Të spiegohet ngjarja (të ndjerit keq, aksident, etj.) dhe të referohet gjithshka që shikohet
- Të tregohet sa persona janë të komplikuar
- Të komunikohet gjendja e personit të komplikuar: përgjigjet, merr fryshtëzim, ka humbje gjaku, ka dhimbje?
- Të komunikohen situata të veçanta: femijë i vogël, grua shtatzenë, person i moshuar, person me sëmundje të njoitura (kardiopatia, azma, diabet, epilepsia, etj. ).

### E RËNDËSISHME

- ⇒ Bashkëbisedimi duhet të bëhet me zë të qartë dhe duhet të jepen të gjitha të dhenat e kerkuara nga operatori që ka detyrë t'i analizojë: nuk është një humbje kohe !!
- ⇒ Në fund të bashkëbisedimit sigurohuni që aparati telefonik të vihet në rregull në vendin e duhur.
- ⇒ Të lihet i lire telefoni i përdorur për të thirrur ndihmën e shpejtë : mund të jeni i kontaktuar në çfarëdo lloj momenti nga Qendra Operative për sqarime ose instruksione të mëtejshme.

## NE PRITJE TE NDIHMAVE

### Çfarë duhet të bëhet

- Përbahuni udhëzimeve telefonike të dhëna nga personeli i 1-1-8.
- Të mbulohet pazienti e të mbrohet nga ambienti.
- Të inkurajohet e të sigurohet pacienti.
- Në rast aksidenti, mos pengohet arritja e ndihmave dhe të njoftohen kalimtarët.
- Të zbërdheni me delikatese rrobat e ngushta (rripi, kravata) për të lethesuar frymëmarrjen.

### Çfare nuk duhet të bëhet

- MOS bihet në panik
- MOS spostohet personi i traumatizuar bëhet vetëm në raste të detyrueshme për situatat e rrezikut ambiental (gazi, zjarri, rrezik shembje eminente, etj).
- MOS jepet për të ngrënë e pirë.
- MOS jepen ilaçe.

## E RËNDËSISHME

**Mos mbani të zënë KURRE linjën telefonike të numrit të përdorur për të thirrur ndihmat: mund të kontaktoheni në çfarëdolloj momenti nga Qendra Operative për sqarime ose instruksione të mëtejshme.**

## KUR NUK DUHET T'I TELEFONOHEȚ 1 – 1 – 8

- Në të gjitha situatat të konsideruara jo urgjente
- Për të kerkuar konsultime specialistike mjeksore.
- Për të patur informacione të natyrës së shërbimit shëndetsor : oraret e shërbimeve, prenotimeve të vizitave ose të kerkimeve diagnostike, farmacitë në turn.

## NDIHMA E SHPEJTE (IL PRONTO SOCCORSO)

### Çfare është

Ndihma e Shpejtë e spitalit është struktura që garanton vetëm kurimin e gjendjeve të jashtëzakonshme – urgjencave, ose të atyre situatave patologjike, të papritura ose traumatike, që kërkojnë ndërhyrje të menjëherëshme diagnostike e terapeutike.

### Kur të shkohet

Eshtë mirë të shkohet në Ndihmën e Shpejtë për probleme akute urgjente dhe që nuk zgjidhen nga mjeku i familjes, nga pediatra e zgjedhur vetë ose nga mjekët e shërbimit pa ndërprerje. (ish mjeku i rojes).

### Kur nuk shkohet

Ndihma e Shpejtë nuk është strukturë në të cilën thellohen aspektet klinike jo urgjente ose kronike.

Për këtë arësy, mos iu drejtoni NSh (Ndihmës së Shpejtë):

- për të evituar listën e pritjes në rast të vizitave specialistike jo urgjente
- për marrjen e recetave e /o çertifikatave
- për të bërë kontolle klinike të pa motivuara nga situata urgjente
- për të evituar shkuarjen tek mjeku juaj kurues
- për të patur shërbime që mund të behen në qëndrat ambulatore
- për komoditet, per shprehi (zakon), për të evituar pagesën e ticket.

### E RËNDËSISHME

Çdo vizitë e kotë në Ndihmën e Shpejtë është një pengesë për kë ka nevojë.

Një përdorim korrekt i strukturave shëndetsore eviton mossħerbimet për vetë strukturat edhe për përdoruesit e tjerë.

Një funksion i mirë i Ndihmës së Shpejtë varet nga të gjithë.

## HYRJA (ARRITJA) NË NDIHMËN E SHPEJTË (IL PRONTO SOCCORSO)

### Si hyhet (arrihet)

Hyhet në Ndihmën e Shpejtë direkt ose me ambulancë duke i telefonuar numrit 1-1-8.

### Triage dhe Kodet me ngjyra: semafori i shendetit

- Me arritjen në Ndihmën e Shpejtë, qytetarit i bëhet një vlerësim i menjëhershëm i nivelit të urgjencës nga ana e infermierëve shumë të specializuar, pajiset me kod me ngjyrë që stabilizon prioriteten e hyrjes për kurat në bazë të gravitetit të rastit dhe pamvarësish nga rradha e arritjes në spital.

Një metodikë e tillë quhet “Triage”  
ka qëllim të evitoj pritjet për rastet urgjente.
- Triage nuk shërben për të shkurtuar kohën e pritjes por përkundrazi për të garantuar që pacientët në gjëndje shumë të rëndë, nuk duhet të presin minuta të vlefshme për jetën.



**Kodi kuq:** shumë kritike, rrezik vdekje, prioritet maksimal hyrje e menjëhershme në kurat;



**Kodi i verdhe:** gjendje kritike, prezenca e rreziqeve evolutive, rrezik potencial i jetës; shërbime të pa shtyshme;



**Kodi jeshil:** gjendje pak kritike, mungesa e rreziqeve evolutive, sherbime që mund të kruhen më vonë;



**Kodi i bardhë:** gjendje jo kritike, pacientë jo urgjent.

### E RËNDËSISHME

Në Ndihmën e Shpejtë ka prioritet pacienti në gjëndje më të rëndë dhe jo ai që arrin më pare.

Të arrish me ambulancë në Ndihmën e Shpejtë nuk do të thotë që të vizitoheni në kohë me të shpejtë.

## CA - SKEDA N. 6

### SHËRBIMI I ASISTENCËS PA NDËRPRERJE ish Mjeku i rojes (IL SERVIZIO DI CONTINUITÀ ASSISTENZIALE – ex Guardia medica)

#### Çfarë është

- Eshtë shërbim që, në mungesë të mjekut të familjes, garanton asistencë mjeksore, për situata të karakterit që nuk mund të shtyhen, që do të thotë për ato probleme shëndetsore për të cilat nuk mund të pritet deri në hapjen e ambulatorit te mjekut kurues personal ose të pediatres të zgjedhur vetë.
- Sherbimi është aktiv në orët e natës ose në ditët e festave e parafestave.
- Mjeku i vazhdimësisë së asistencës mund:
  - të bëjë vizita në shtëpi, për të cilat nuk mund të pritet
  - të japë receta për ilaçe për terapi që nuk mund të presin ose te domosdoshme për vazhdimësinë e terapisë për të cilat ndërprerja mund të keqësojë gjendjen e personit
  - të lëshojë çertifikata për sëmundje në raste domosdoshmerie dhe për një kohë maksimale për tre ditë.
  - propozon shtrimin në spital

#### Si behet kjo

Kjo bëhet nëpërmjet numrit telefonik të posaçëm që mund të merret nga secili në ASL- e vet. Mjeku i shërbimit pa ndërprerje në bazë të vlerësimit të gjëndjes së përshkruar, mund të per gjigjet nëpërmjet këshillave telefonike, vizitës ambulatore (ku është e mundur) ose vizitës në shtëpi.

Eshtë përgjegjesi e mjekut, edhe në bazë të një linje në nivel kombtar e /o krahinor të vlerësojë se është e domosdoshme vizita në shtëpi.

#### Kur telefonohet

Për probleme shëndetsore që manifestohen natën ose në ditët e festave e parafestave, kur mjeku personal kurues nuk është në shërbim, dhe për të cilat nuk mund të pritet.

- Shërbimi është aktiv :
  - natën: nga e hëna deri të djelën, nga ora 20.00 deri në orën 08.00
  - ditën: - në ditët e parafestave, nga ora 10.00 deri në orën 20.00
    - në ditët e festave, nga ora 08.00 deri në orën 20.00

#### Kur nuk telefonohet

Për probleme të gjendjeve të jashtëzakonëshme ose të urgjencës shëndetsore (për të cilat kontaktohet direkt Shërbimi i gjëndjes së jashtëzakonëshme – urgjenca 1-1-8). Për lëshim recetash për analiza dhe vizita specialistike.